



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4874 Prot.

Roskovec, më 26, 06 2026

VENDIM

NR 30 .DATË 25 .06 .2026

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN MAJ 2026”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.05.2026, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Maj 2026.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3942/1 Prot.

Roskovec, më 29.05.2026

Procesverbal Nr.5

-I mbajtur sot, datë 29.05.2026, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Prill 2026.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Prill 2026.
5. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2025.
6. Për një shtesë në Paketën Fiskale për vitin 2026.
7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13³¹

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, A.Pelo, S.Bibo Qamili.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, Rr.Hazizi, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, V.Çepele, F.Feleqi, Zh.Metushi.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomike O.Goga, P/Ardhurave Vendore M.Dardha, P/Shërbimit Social E.Kola.

Me plotësimin e kuoromit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 11 këshilltarë. Kryetari – duke qënë se pas bërjes së apelit kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e kësaj mbledhje të Këshillit të Bashkisë Roskovec u realizuar pak me vështirësi, kjo bëri që mbledhja të fillojë pak më vonë sesa afati i parashikuar për zhvillimin e kësaj mbledhje. Ju falenderoj të gjithë këshilltarët e pranishëm në këtë mbledhje. Të nderuar këshilltar ashtu siç keni marr njoftim, në datën 22.05.2026 Kryesia e Këshillit të Bashkisë Roskovec ka vendosur datëmbledhjen e muajit Maj pikërisht këtë ditën e sotme, ditën e Premte datë 29.05.2026. Jeni njohur me rendin e ditës dhe gjithë materialet e kësaj mbledhje, me gjithë projekt-vendimet e paraqitura nga administrata e

Bashkisë për këtë mbledhje, nuk kemi asnjë ndryshim sa i takon njoftimit që ju keni marr për rendin e ditës, në qoftë se dikush nga ju kërkon fjalën për rendin e ditës përpara se ta kalojmë në votim? Fjalën e ka z.Elmaz. Elmazi- faleminderit Kryetar, unë mendoj se meqënëse filluam me vonesë, nga pika 1 deri tek pika 4 për dhënien e ndihmave ekonomike të hidhen në votë, nuk ka pse diskutohen..Kryetari- faleminderit z.Elmaz..Leksi- kompensojmë dhe vonesën..

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari- atëherë kush është dakort me rendin e ditës së kësaj mbledhje? Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro të këshilltarëve të pranishëm në këtë sallë miratohet rendi i ditës.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Prill 2026.

Kryetari- jeni njohur gjithashtu me një informacion të shkurtër në lidhje me projekt-vendimet e shqyrtuara dhe miratuara apo jo nga ky Këshill në mbledhjen e muajit të kaluar, pra pikërisht në mbledhjen e muajit Prill. Ka nevojë që..atëherë vazhdojmë me propozimin e bërë nga z.Elmaz.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- jeni njohur, keni pas kohën e mjaftueshme, kush është pro? Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar, faleminderit për votimin.

4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Prill 2025.

Kryetari- në bazë të propozimit të z.Elmaz, unë edhe këtë projekt-vendim e hedh në votim, kush është pro? Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro të anëtarëve të pranishëm miratohet ky projekt-vendim.

5. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2025.

Kryetari- ftojme specialisten që shkurtimisht në mënyrë të përmblodhur të lutem ta relatosh projekt-vendimin znj.Orgesa. Dr.Financës Orgesa- përshëndetje të gjithëve, të nderuar këshilltar jam para jush për tju paraqitur bilancin e konsoliduar të Bashkisë dhe të Ndërmarrjes. Këtu në pasqyrën 1 kemi tabelën ku tregohet realizimi i shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik për periudhën Janar-Dhjetor 2025, i ndarë me programe. Siç vërehet dhe nga tabela e mësipërme plani i buxhetit të Bashkisë dhe njësia shpenzuese që është Ndërmarrja, është në vlerën 1.1 milion lekë, ndërsa fakti për këtë periudhë është 907 milion, pra me një përqindje të realizimit 82%. Shpenzime nga grandit i pakushtëzuar dhe specifik ka qënë i planifikuar në vlerën 322 milion dhe shpenzimi faktik i realizuar nga ky grand janë në vlerën 279 milion, me një vlerë 86%. Shpenzimet e

planifikuara për këtë periudhë nga të ardhurat që mbledh vet Bashkia kanë qënë në vlerën 454 milion dhe fakti i realizuar është në vlerën 301 milion, pra realizimi në masën 66.4%. Shpenzimet nga fondet e kushtëzuara në plan kanë qënë në vlerën 329 milion dhe fakti nga fondet e kushtëzuara është 326 milion, e shprehur në përqindje është gati 99.2% realizimi. Pasqyrat financiare të vitit 2025 janë realizuar në përputhje me kërkesat sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, gjithashtu dhe Vendimit të Këshillit “Për miratimin e planit kontabël publik të organit të pushtetit lokal”, të udhëzimit Nr.30 me ndryshimet përkatëse “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, udhëzimi Nr.8 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare” të aparatit gjithashtu dhe njësitë shpenzuese. Konsolidimi i pasqyrave financiare është bërë në datë 31.03.2026, vlera financiare e konsoliduar për Bashkinë Roskovec pasqyrohet qartë në këtë pasqyrë, të cilat janë të verifikueshme në analizë sipas dokumentave shoqëruese bashkëngjitur këtij materiali. Bashkëngjitur keni gjithë tabelat e bilanceve të aparatit, gjithashtu dhe Ndërmarrjes, kështu që unë nuk po rri që ti lexoj çdo zë, nëse keni ndonjë pyetje unë jam gati që tju përgjigjem. Kryetari- atëherë të nderuar këshilltar të shfytëzojmë rastin që kemi specialisten akoma të gatshme, kush e kërkon fjalën për pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim, pra për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2025? Asnjë nga këshilltarët nuk e kërkon fjalën, për diskutim? Atëherë pyetje dhe diskutime nuk ka në lidhje me këtë projekt-vendim, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2025”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet ky projekt-vendim, faleminderit për votimin, faleminderit dhe juve znj.Orgesa.

6. Për një shtesë në Paketën Fiskale për vitin 2026.

Kryetari- është pikërisht një projekt-vendim i cili ka ardhur për herë të dytë për tu shqyrtuar dhe votuar nga ky Këshill, dhe është pikërisht projekt-vendimi “Për një shtesë në Paketën Fiskale për vitin 2026”. Specialistja do të na thojë besoj argumentat shtesë që ka sjellë në lidhje me këtë projekt-vendim, do të lutem pa emocion dhe fare shkurt. Përgjegjëse e Dr. së të Ardhurave Vendore Marjola- përshëndetje të gjithëve, jam këtu për tju paraqitur një shtesë mbi nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, që ka lidhje me tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset dhe institucionet. Duke qënë se subjektet e ndërtimit..Në këtë moment vjen këshilltari Zhaku Metushi, ora 13³⁸. Prezent tani në sallë janë 12 këshilltarë. Nënkryetari Maksi- kjo është sqaruar në mbledhjen e parë..Leksi- le ta dëgjojmë të përmbledhur se specialistja e filloi..Kryetari- z.Maksi të lutem mos ta ndërpresim specialisten..Maksi- po e tha Drejtori herën e parë..Kryetari- i kemi kërkuar diçka specialistes por nuk keni qënë i pranishëm në sallë në momentin që kemi komunikuar, kështu që të lutem dhe pak durim që ta dëgjojmë..Marjola- sipas subjekteve të ndërtimit dhe investimit që ata kryejnë në Bashkinë e Roskovecit, për vlerat e investimit ne kemi përcaktuar dhe një taksë fikse sipas vlerës së investimit që ata kryejnë. Për vlerën e investimit nga 200 milion deri në 500 milion kemi përcaktuar një tarifë e cila është 3 milion lekë. Për vlerën e investimit nga 500 milion e 1 lekë deri në 10 milion kemi përcaktuar po ashtu një vlerë tjetër të tarifave, domethënë kemi pasur një vlerë minimale deri në 200 milion lekë dhe tani janë shtuar në vlerë maksimale deri në 15 miliard. Kryetari- faleminderit, për pyetje në lidhje me projekt-vendimin e kërkon dikush fjalën? Për diskutim? Atëherë pyetje dhe diskutime nuk kemi, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për një shtesë në Paketën

Fiskale për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 1 votë abstenim A.Pelo. Kryetari- me 11 vota pro, 1 abstenim miratohet ky projekt-vendim.

7.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari- duke ju falenderuar për votimin, doja tju kujtoja se jemi me pikën e fundit të rendit të ditës të kësaj mbledhje, që është diskutime dhe komente nga qytetarët. Nuk kemi të regjistruar asnjë kërkesë për koment apo diskutim. Duke ju falenderuar edhe një herë për pjesmarrjen në këtë mbledhje dhe për votimin, unë e deklaroj..Elmazi- kush ka ndonjë gjë për të thënë z.Kryetar le ta thotë, nga anëtarët e Këshillit. Kryetari- nuk kemi thamë të regjistruar asnjë. Atëherë unë e deklaroj këtë mbledhje të Këshillit të Bashkisë Roskovec të mbyllur.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Afrim Plaka